



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 23.05.2013
Nr. 0204-638

PËR: Naim Ismajli, Kryetar i Komunës së Shtimes
Kujtim Xhelili, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Shtimes

**LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS
SË SHTIMES, Nr. 01/101, Pranuar me datë, 15.05.2013**

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit Nr. 01/101 të miratuar me datë 30.04.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi Nr. 01/101, për themelimin e komisionit AD-HOC për vlerësimin e ofertave dhënie në shfrytëzim pronën e paluajtshme komunale.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana: 23.05.2013
br. 0204-638

Za: Naim Ismajli, Gradonačelnik Opštine Štimlje
Kujtim Xhelili, Predsedavajući Skupštine Opštine Štimlje

PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKE OPŠTINE ŠTIMLJE
, Br. 01/101, Primitljeno dana, 15.05.2013

Poštovani-e

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim po Zakonu za lokalnu samoupravu Br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja Odluke Br. 01/101 usvojene dana 30.04.2013, **POTVRDJUJE** zakonitost ovog akta i ceni da je isti u skladu sa Zakonom za lokalnu samoupravu .

Pravni Akt navaden u nastavku, ima puni pravni efekat .

- Odluka Br. 01/101 , za odredjivanje AD-HOC komisije za procenu ponuda za davanje na korišćenje nepokretne opštinske imovine.


S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamanikpremijera i Ministar MALS-a,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Rukovodiocima uprava MALS-a
Arhivi MALS-a.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL-SHTIME
01Nr. 06/914, Datë: 22.4.2013



Npi – 01/101, Datë: 30.4.2013

Kuvendi Komunal-Shtime, shqyrtoi kërkesën e Kryetarit të Komunës 01Nr.07/833, datë:10.04.2013, për formimit të komisionit Ad-Hoc, që ka të bëjë me vlerësimin ofertave për dhënjën në shfrytëzim afatshkurtë ose afatgjatë të Pronës së pa luajtshme Komunale. Duke u bazuar në nenin 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; si dhe nenin 8 të Ligjit Nr.04/L-144 për dhënjën në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, Kuvendi vendosi që të miratoi, kërkesën e Zyrës së Kryetarit 01Nr.07/833, duke marrë për bazë edhe Rekomandimet e Komiteti për Politikë dhe Financa, dhe në mbledhjen e mbajtur më datën: 30.4.2013, mori këtë:

V E N D I M

MBI THEMELIMIN E KOMISIONIT AD-HOC PËR VLERËSIMIN E OFERTAVE PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM PRONËN E PALUAJTSHME KOMUNALE

I

Kuvendi Komunal-Shtime në mbledhjen e katërt të rregullt për vitin 2013, të mbajtur më datën: 30.4.2013, unanimisht aprovoi Vendimin për themelimin e Komisionit, (Ad-Hoc), që ka të bëjë me vlerësimin ofertave për dhënjën në shfrytëzim afatshkurtë ose afatgjatë për biznese në pronën e pa luajtshme të Kuvendit Komunal-Shtime, i cili duhet të jetë i përbërë prej 7 anëtarëve si vijon:


1. Kuvendi i Komunës, përfaqësohet me tre (3) anëtar nga subjektet e ndryshme të përfaqësuara në Kuvend, të cilët zgjedhen sipas kësaj formule: Një anëtarë nga pozita, z.Fehmi Hysenaj – Kryetar i Komisionit, dhe dy anëtarë nga opozita, z.Kemajl Sadriu, dhe z.Adriatik Beqa.
2. Ekzekutivi i Komunës përfaqësohet me tre (3) anëtarë, znj.Ajshe Tërshani, znj. Minire Halili dhe z.Bashkim Ahmeti.
3. Shoqëria Civile përfaqësohet me një (1) anëtar, z.Halim Baftiu nga fshati Davidovc.

II

Komisioni vlerësues merr detyra dhe përgjegjësi në harmoni me Ligjin Nr. 04/L-144 për dhënjën në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Anëtarëve, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, dhe Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesi i Kuvendit
Kujtim Xhelili